

STATUTI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"E2 ESTATE" Sh.p.k.

Mbi bazën e kërkesave të ligjit Nr. 9901 të datës 14.04.2008 "Përshoqëritë tregtare" dhe të ligjit Nr. 9723 të datës 03.05.2007 "PërQendrënKombëtare të Regjistrimit" krijohet shoqëria tregtare "E2 ESTATE" sh.p.k., e cila do të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

KAPITULLI I
EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRITARISE, SELIA, KOHEZGJATJA

NENI 1

EMERTIMI I SHOQERISE DHE THEMELUESIT

Krijohet shoqëria tregtare e emërtuar "E2 ESTATE" sh.p.k., me ortakë:

1. Ortaku **Z.Brion Brinja**, lindur në Vlorë, Shqipëri, me 13.09.1989, i identifikuar me Kartë Identiteti me Nr Personal : I90913006B;
2. Ortaku **Z.Eugent Shkurti**, lindur në Tiranë, Shqipëri, me 12.09.1987, i identifikuar me Kartë Identiteti me Nr Personal : I70912033J;

NENI 2

SELIA

Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Rruga "Ismail Qemali", Nd.18, H.1, Kashar, Yzberisht, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria mund të çele, seli të tjera të dyta, dege, përfaqësimi apo agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, në përputhje me ligjin në fuqi.

NENI 3
KOHEZGJATJA

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat kohor të pacaktuar.

NENI 4
VULA

Shoqëria do të ketë vulën e saj.

NENI 5
OBJEKTI

Shoqëria do të ketë Statutin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojë humbje deri në kufirin e kontributit të themeluesve të saj në kapitalin fillestar.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë: Agjensi Imobiliare. Studime tregu për pasuri të paluajtshme. Komisioner dhe agjensi për të tretë. Trajnime dhe konsulencë në trajtimin dhe shitjen e

pasurive të paluajtshme. Konsulencë për shitje dhe blerje, qiramarrje dhe qiradhënie Çdo shërbim tjetër në lidhje me tregun imobilar në të gjithë nivelet e shërbimit. Konsulencë tregtare e marketingu, shërbime të tjera të ngjashme. Operacione tregtare në komisioneri. Komisioner për marrjen me kontrate zhvillimi % të trojeve mes paleve. Konsulencë për shitje dhe qera të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, dhe çdo veprimtari tjetër pa kufizim që ka lidhje me ndërmjetësimin kombëtar dhe ndërkombëtar të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme.

KAPITULLI II **KAPITALI**

NENI 6 **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali fillestarë i shoqërisë është i barabartë me 20000 (njetëmijë) leke, i cili miratohet nga ortakët, dhe nuk është i derdhur nga ortakët themelues dhe ndahet në 2 (dy) kuota me vlerë të barabartë me 10000 (dhjetmijë) leke, që përbejnë 100 % (nëqind për qind) të kapitalit të shoqërisë;

Kapitali është i ndarë mes ortakëve themelues si më poshtë:

- 1) Ortaku **Z. Brion Brinja**, mbajtës i 1 (një) kuote me vlerë nominale të barabartë me 10000 (dhjetmijë) leke që përben 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të shoqërisë;
- 2) Ortaku **Z. Eugent Shkurti**, mbajtës i 1 (një) kuote me vlerë nominale të barabartë me 10000 (dhjetmijë) leke që përben 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të shoqërisë;

NENI 7 **PJESËMARRJET NE KAPITALIN THEMELTAR**

Pjesëmarrjet e ortakëve në kapitalin themeltar përcaktohet në raport të drejtë me kontributet e tyre në kapitalin themeltar.

Te drejtat, përfshirë edhe te drejtat e votës, u takojnë ortakëve në mënyrë përpjesëtimore me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin themeltar.

Në rast tjetërsimi të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar, ortakët e tjerë gëzojnë te drejtën e parablerjes. Me "tjetërsim" nënkuptojmë çdo akt tjetërsimi i kuotave, në kuptimin me të gjere të fjalës, si në pronësi të plote ashtu dhe të pjesshme, që, në mënyrë direkte apo indirekte, sjell ndryshimin e titullit të pronësisë mbi kuotat ose te drejtat mbi to.

Ortaku që synon të tjetërsojë, tërësisht ose pjesërisht, kuotat e tij në kapitalin themeltar duhet t'i komunikojë ortakëve të tjerë në asamble ose nëpërmjet letrë rekomande, ofertën e marre, duke treguar emrin e blerësit të mundshëm dhe kushtet e tjetërsimit, në mënyrë të veçantë çmimin e përcaktuar dhe mënyrat e pagesës (këtu e me poshtë oferta).

Brenda njëzet ditëve nga marrja e komunikimit të Ofertës, ortakët e interesuar në ushtrimin e se drejtës së parablerjes duhet t'i komunikojnë ortakut që kalon te drejtat mbi kuotat, dëshirën për të ushtruar te drejtën e parablerjes, përpjesëtimisht me pjesëmarrjen e secilit në kapitalin themeltar dhe sipas kushteve të Ofertës, duke shprehur edhe interesin e mundshëm për blerjen e pjesës së kuotave për të cilën nuk është ushtruar e drejta e parablerjes nga ana e ortakëve të tjerë. Është i pavlefshëm çdo komunikim që nuk përmban të gjithë të dhënat e mësipërme.

Në rast se ndonjë nga personat që gëzon te drejtën e parablerjes së kuotave, nuk mund ose nuk dëshiron ta ushtroje atë, e drejta e parablerjes që i takon zmadhohet automatikisht dhe përpjesëtimisht në favor të ortakëve që kanë shprehur interesin për ta ushtruar këtë te drejte.



Ne rast se janë disa ortake qe ushtrojnë te drejtën e parablerjes, kuotat do te shpërndahen ndërmjet tyre ne përpjesëtim me pjesëmarrjen e secilit ne kapitalin themeltar te shoqërisë. Ne rast se ne letrën e komunikimit te Ofertës tregohet si blerës i mundeshme një person qe është ortak, edhe atij i njihet e drejta e parablerjes, krahas ortakeve te tjerë.

E drejta e parablerjes duhet te ushtrohet për te gjithë pjesëmarrjen e ofruar dhe për çmimin e përcaktuar, duke qene se i tille është objekti i propozimit te paraqitur nga ortaku ofrues.

Ne rastin e ushtrimit te se drejtës se parablerjes, nënshkrimi i kontratës se shitjes se kuotave dhe pagesa përkatëse duhet te kryhen brenda afateve te përcaktuara ne propozimin e shitjes se formuluar nga ortaku ofrues.

Nëse e drejta e parablerjes nuk ushtrohet brenda afateve te mësipërme dhe për tërësinë e pjesëmarrjes se ofruar, ortaku ofrues mund t'i transferoje kuotat e veta ne favor te blerësit te treguar ne komunikimin e Ofertës dhe ne kushtet e parashikuara ne te, brenda gjashtëdhjetë ditëve te ardhshme. Ne te kundërt procedura e parablerjes duhet te përsëritet.

Ne rast tjetërsimi te kuotave ne favor te te tretëve, pa zbatuar dispozitat e parashikuara me sipër, blerësi nuk do te legjitimohet ne ushtrimin e te drejtave administrative dhe pasurore dhe tjetërsimi i kuotave nga ana e tij nuk do te prodhoje efekte ndaj shoqërisë.

Nëse asnjeri prej ortakeve nuk e ushtron te drejtën e parablerjes ne mënyrat e përcaktuara, ortaku ofrues mund te nënshkruajë aktin e shitjes se pjesës se tij ne përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

E drejta e parablerjes nuk është domosdoshmërisht e nevojshme te ushtrohet prej ortakeve, ne rast transferimi tek familjarët, te kuotave ose te pjesëve te kuotave te zotëruara prej tyre.

NENI 8

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqërisë mund te shtohet ose te pakësohet me vendim te Asamblesë se Ortakeve, por asnjëherë nuk mund te zvogëlohet nen nivelin e kapitalit fillestar te derdhur.

NENI 9

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit te njëshoqërie me përgjegjësi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a. Kontributit fillestar;
- b. Shitblerjes;
- c. Trashëgimisë;
- d. Dhurimit;
- e. Çdo mënyretjetër te parashikuar ne ligj.

Ortakët mund te shesin pjesërisht apo tërësisht kuotat e tyre te kapitalit. Shitja e kuotave tek te tretet behet vetëm pasi te ketë marre vendim Asambleja e Ortakeve dhe nëpërmjetkontratës se shitjes se kuotave te kapitalit.

KAPITULLI II

ORAGENET DREJTUESE

NENI 10

ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese te shoqërisëjanë:

- Asambleja e Ortakeve;
- Administratori.



NENI 11 ORGANI VENDIMARRËS

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëmvendimmarrës i shoqërisë, ortaket vendosin mbi çështjet që i rezervohen nga ligji ose nga ky Statut, si dhe mbi çështjet që njeri ose disa prej administratorëve i paraqesin për miratim.

Ortaket gëzojnë të drejtën të thërrasinasamblenë e ortakeve në rastet dhe me shumicat e përcaktuara në ligj.

Janë në çdo rast në kompetencë të Asamblesë që vendos me mazhorancë të thjeshtë të votave të ortakeve pjesëmarrës kur janë prezent me shumë se 30 % e kuotave të kapitalit themeltar, për vendimet që kërkojnë shumicë të zakonshme, si me poshtë:

1. Emërtimin e shkarkimin e administratorit;
2. Emërtimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar, duke përcaktuar në këtë rast kriteret e likuidimit;
3. Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në pikën 1 dhe 2;
4. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo Statuti.

Janë në kompetencën e Asamblesë së Ortakeve e cila vendos me votën në favor të $\frac{3}{4}$ të ortakeve prezent që përfaqësojnë me shumë se gjysmën e kapitalit të shoqërisë, vendimet që kanë lidhje me :

1. Miratimin e bilancit dhe shpërndarjen e fitimeve;
2. Ndryshimet e këtij statuti;
3. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar;
4. Ndryshimin e formës së shoqërisë apo riorganizimin e saj;
5. Shpërndarjen e shoqërisë.

Asambleja mund të mbledhet në mënyrën të jashtëzakonshme kur e kërkojnë administratori apo me shumë se një e treta e ortakeve të shoqërisë. Në mbeshtetje të nenit 88 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ortaket kanë të drejtën për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

NENI 12 MBLEDHJA E ASAMBLESE

Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e parashikuara nga ky Statut dhe në rastet e përcaktuara nga ligji nr. 9901, i 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligje të tjera, dhe çdo herë është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Takimi i rregullt i Asamblesë së Përgjithshme është bërë të paktën një herë në vit.

Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori ose nga ortaket në përputhje me nenin 12 të këtij statuti.

Asambleja e Përgjithshme mbledhet në qoftë se, nga pasqyrat financiare vjetore apo prospektet e rezultateve të ndërmjetme, ekziston rreziku që fitimet e kompanive nuk i mbulojnë detyrimet e duhura për 3 muajt e ardhshëm.

Asambleja e Përgjithshme mbledhet kur shoqëria, brenda dy viteve të para të krijimit të saj, propozon të blejë nga një ortak, asetet me një vlerë mbi 5% të aseteve të shoqërisë që rezultojnë nga deklaratat e fundit financiare e certifikuar.

Në rastet e parashikuara në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, duhet t'i paraqitet Asamblesë së Përgjithshme një raport i detajuar nga një kontabilist i autorizuar me licencë i pavarur.

Nëse asambleja nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit, mbledhja thirret përsëri brenda 30 ditëve me të njëjtin rend dite.

NENI 13 THIRRJA E ASAMBLESE

Asambleja e ortakeve e thirrur rregullisht përfaqëson bashkësinë e ortakeve dhe vendimet e saj të marra në përputhje me ligjin dhe këtë statut janë të detyrueshme për të gjithë ortakët edhe nëse këta mungojnë ose nuk janë të jenjëtit mendim.

Asambleja e Ortakeve thirret me një njoftim me shkrim dërguar ortakeve në vendbanimin e tyre ose në adresën e postës së tyre elektronike.

Njoftimi me shkrim ose me e-mail, duhet të tregojë vendin, datën dhe orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet t'i komunikohet të gjithë ortakeve, jo më vonë se 7 ditë para datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë.

Njoftimi për thirrjen e asamblesë është bërë me shkrim dhe do të dorëzohet për secilin ortak në adresën e regjistruar në regjistrin e ortakeve të paktën 7 (shtatë) ditë para mbledhjes.

Përveç sa me sipër, njoftimi për thirrjen e asamblesë mund të bëhet nëpërmjet dorëzimit të tij administratorit, ky i fundit ka përgjegjësinë e dorëzimit të këtij njoftimi, ortakeve.

Në numërimin e shtatë ditësh nuk merret parasysh, dita e dorëzimit të njoftimit dhe dita e mbajtjes së mbledhjes.

Kur asambleja nuk është mbledhet në mënyrën e përshkruar më lart, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në qoftë se është përfaqësuar tërësia e kapitalit themeltar dhe asnjë nga anëtarët nuk kundërshtojnë diskutimin e çështjeve në rend të ditës.

Asambleja drejtohet nga administratori. Drejtuesi i Asamblesë konstaton mbledhjen e rregullt të saj, verifikon identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmeve, drejton dhe garanton zhvillimin e rregullt të saj të asamblesë si dhe verifikon dhe shpall rezultatet e votimeve.

Mbledhja e Asamblesë së ortakeve mund të mbahet edhe nëpërmjet video- konferencës ose telekonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe të dallohen në çdo moment të lidhjes dhe t'u lejohet të ndjekin diskutimin, të marrin, të dërgojnë dhe të vëzhgojnë dokumentet, të ndërhyjnë gojshisht dhe në kohë reale mbi të gjitha çështjet, si dhe të marrin pjesë në votim dhe të vendosin, në mënyrë të tillë që të mund të garantojë metoda kolegjiale dhe zbatimi i parimeve të mirëbesimit dhe barazisë së trajtimit të ortakeve. Në prani të kushteve të mësipërme, asambleja e ortakeve konsiderohet e mbajtur në vendin në të cilin gjendet drejtuesi i saj ose në vendin që tregohet në njoftimin e mbledhjes së saj. Çdo ortak ka të drejtën e pjesëmarrjes dhe të votës në asamble në përpjesëtim me pjesëmarrjen që zotëron në kapitalin themeltar.

Ortakët mund të përfaqësohen në asamble nga persona të tjerë nëpërmjet një autorizimi apo prokure të posaçme. Autorizimi apo Prokura është e vlefshme vetëm për asamblesën për të cilën kërkohet, të identifikuar sipas rendit të ditës gjithashtu përfshin takime pasuese me të njëjtin rend dite. Ortaket nuk mund të përfaqësohen nga administratori i shoqërisë.

Vota duhet të jetë e hapur ose gjithsesi të shprehet me modalitete të tilla që të bëjnë të mundur identifikimin e ortakeve që nuk janë në të njëjtin mendim. Modalitetet e votimit miratohen nga Asambleja e ortakeve me shumicën e të pranishmeve, mbi propozimin të administratorit.

NENI 14 AKTET DHE VERBALET E MBLEDHJES SE ASAMBLESE

Vendimet e Asamblesë së Ortakeve duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes. Administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e procesverbalit të mbledhjes së asamblesë.

Procesverbali duhet të ketë datën dhe vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Presidentit dhe i cili e mban procesverbalin, rezultatet e votimit.

Procesverbalit te Asamblesë i bashkëngjitet lista e pjesëmarrësve dhe njoftimi për mbajtjen e takimit.
Procesverbali i mbledhjes do të nënshkruhet nga të gjithë ortaket e pranishëm dhe nga ai që e përpilonatë.

NENI 15 KUNDERSHTIMI I VENDIMEVE TE ASAMBLESE

Administratorët dhe secilido ortak ka të drejtë të ankohet për vendimet e asamblesëpranë Gjykatës së Shkallës së Parë, ku është selia e kompanisë, nëse vendimet janë në kundërshtim me ligjin ose me statutin.

Citati, i përshkruar në paragrafin e mëparshëm, është drejtuar kundër shoqërisë dhe duhet të dorëzohet brenda 3 (tre) muaj nga vendimi.

Nëse vendimi është kundërshtuar nga ana e administratorit të shoqërisë, Gjykata e Shkallës së Parë, ku Selia shoqëria, emëron një përfaqësues të shoqërisë në gjykatë.

Gjykimi i pavlefshmërisë ka efekt në lidhje me të gjithë ortaket dhe administratorët.

Për raste që nuk rregullohen në këtë statut do aplikohet ligji.

NENI 16 ADMINISTRIMI

Asambleja e Ortakeve ka te drejte te vendose nëse administrimi i shoqërisë do te behet nga një administrator i vetëm apo nga Këshilli Administrativ i përberë nga minimumi 3(tre) dhe maksimumi 5 (pese) administratorë.

Administrimi i shoqërisë i cili konsiston ne kryerjen e te gjithë veprimeve te administrimit për realizimin e objektit te veprimtarisë se shoqërisë, i besohet administratorit te vetëm ose Këshillit Administrativ. Ne rastin e Këshillit Administrativ secili nga administratorët është i detyruar te informoje Këshillin për çdo veprim te kryer dhe ne rast kundërshtish vendos Asambleja e Ortakeve. Administratori i vetëm ose Administratorët (nëse janë emëruar qëndrojnë ne detyre 5(pese) vjet, me te drejte riemërimi, përveç nëse shkarkohen nga Asambleja e Ortakeve apo rastet e dorëheqjes. Kushdo qe administron shoqërinë përgjigjet personalisht përballë saj dhe te trentëve për shkelje te mundshme te ligjit dhe ose statutit dhe ose gabimet e kryera gjate administrimit te shoqërisë.


Ne rast te administrimit me Këshill Administrimi, ky zgjedh brenda tij President dhe një Administrator te Deleguar. Presidenti i Këshillit te Administrimit duhet te thërrasë Këshillin te paktën një here ne dy muaj dhe te njoftoje Këshillin e Administrimit për mbarëvajtjen e shoqërisë. Nëse ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet administratorëve, Presidenti duhet te thërrasë Asamblenë e Ortakeve, e cila mund te vendose ne lidhje me kundërshtitë.

Ne rastin e Këshillit Administrativ, administratorët mund te veprojnë bashke ase veç e veç. Ne çdo rast, nëse ekzistojnë kundërshtime ndërmjet administratorëve këta i drejtohen Asamblesë se ortakeve, e cila dhe mund te zëvendësojë Këshillin e Administrimit e te emëroje administratorë te tjerë. Administratori ose Këshilli Administrativ mund te shkarkohen ne çdo moment me vendim te Asamblesë se Ortakeve me votën pro te ortakeve qe përfaqësojnë shumicën e kapitalit te shoqërisë, pa detyrim motivimi. Megjithatë nëse shkarkimi është bere pa arsye te drejte, administratori mund te kërkojë dëmshpërblim financiar.

Ne rastin e dorëheqjes se një administratori, brenda 30 (tridhjetë) ditëve duhet te thirret Asambleja e Ortakëve për emërimin e administratorit te ri, ne rast se ky vendim nuk merret ne te njëjtën mbledhje Asambleje kur është vendosur largimi i administratorit.

Shoqëria e themeluar do te administrohet nga një administrator i vetëm i cili do te qëndrojë ne detyre për një periudhe 5 vjeçare, me te drejte rizgjidhje.

Me themelimin e shoqërisë, emërohet AdministratorOrtaku **Z.Brion Brinja** , lindur ne Vlorë , Shqiperi, me 13.09.1989, i identifikuar me Karte Identiteti me Nr Personal : I90913006B,për 5 vjet.



Emërimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

NENI 17 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka te gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm dhe te jashtëzakonshëm te shoqërisë, me përjashtim te vendimeve qe ligji, statuti, akti i themelimit i rezervojnë Asamblesë se Ortakeve.

Administratori gëzon te drejta te pakufizuara ne lidhje me administrimin e llogariserrjedhese te shoqeriseprane cdo banke , hapjen dhe mbylljen e llogariverrjedhese ne cdo moment prane cdo banke, administratori ka te drejtenpër kryerjen e çdo veprimi dhe /ose operacioni qe evlerësojne te dobishëm për realizimin e objektit te shoqërisë.

Administratori drejton veprimtarinë e shoqërisë dhe ka te drejte qe ta përfaqësoje atë ne marrëdhëniet me te tretet.

Përveç asaj çka parashikohet nga ligji, Administratori ka detyrën e kryerjes se veprimeve te mëposhtme:

1. përgatit dhe harton inventarin, te llogarive vjetore dhe raportit me shkrim mbi administrimin, raportin e ecurisë se veprimtarisë se shoqërisë, ne mbyllje te çdo viti financiar dhe se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ja dërgon Asamblesë se Ortakeve për miratim;
2. hartimin e projekteve te bashkimit ose te ndarjes se shoqërisë;
3. te informoje asamblenë mbi zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e operacioneve tregtare me rendësi për shoqërinë;
4. te raportojë përpara Asamblesë se Ortakeve mbi faktet qe mund te kenë pasoja negative mbi ecurinë apo ekzistencën e shoqërisë;
5. Administratorët mund te delegojnë përfaqësues te posaçëm për kryerjen e akteve te veçanta ose te një kategori aktesh, duke përcaktuar kompetencat përkatëse;
6. Te thërrasë Asamblenë e Ortakeve ne rastet e parashikuara me ligj;
7. Si dhe çdo te drejte tjetër e cila është përcaktuar me ligj për arritjen e qëllimit te shoqërisë

NENI 18 PERFAQESIMI I ADMINISTRATORIT


Administratori ka te drejtën e përfaqësimit te shoqërisë kundrejt te trentëve dhe ne gjykim. Ai mund te caktojë avokate dhe përfaqësues te shoqërisë përpara organeve gjyqësore, organeve te administratës shtetërore dhe te trentëve, si dhe përfaqësues te posaçëm për akte te veçanta apo kategori aktesh.

E drejta e firmës se shoqërisë mund te ushtrohet edhe nga personat te cilëve u është deleguar kjo e drejte brenda kufijve te kompetencave te dhëna.

Administratori ka te drejtën e rimbursimit te shpenzimeve te bëra gjate ushtrimit te funksioneve si dhe një shpërblim vjetor te përcaktuar nga asambleja e ortakeve ne momentin e emërimit ose me vendim te posaçëm.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR

NENI 19 VITI FINANCIAR



Veprimtaria ekonomiko-financiare e shoqërisë nis me regjistrimin e saj ne organet tatimore, ndërsa për vitet ne vijim nga data 1 janar deri me 31 dhjetor te çdo viti. Ne fund te çdo periudhe te ushtrimit te aktivitetit hartohet bilanci kontabël, brenda afateve dhe konform ligjeve ne fuqi. Dokumentet e kontabilitetit, te shoqëruar nëse e nevojshme nga relacioni i ekspertit kontabël te autorizuar, duhet t'u komunikohen ortakeve dhe te vihen ne dispozicionin e tyre pranë selisë se shoqërisë, te paktën 15 dite përpara datës se mbledhjes se asamblesë. Shoqëria ka llogarinë rrjedhëse te saj si dhe librat kontabël ne përputhje me kërkesat e ligjit për kontabilitetin dhe dispozitave te tjera fiskale ne Republikën e Shqipërisë Transferimi i vlerave monetare dhe transaksionet financiare do te kryhen ne baze te kritereve te përcaktuara nga Banka e Shqipërisë.

NENI 20 MARREDHENIET E PUNES

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratave te punës dhe konform Kodit te Punës se Republikës se Shqipërisë.

NENI 21 FITIMET

Fitimet qe rezultojnë nga bilanci ushtrimor do te shpërndahen ndërmjet ortakeve pasi te jene zbritur nga kjo shume vlera e humbjeve te pësura gjate vitit ushtrimor paraardhës si dhe 5%(pese për qind) qe destinohet për fondet e rezervës se domosdoshme, derisa kjo te ketë arritur kufirin e parashikuar me ligj.

Pjesa qe mbetet pas zbritjes se zërave te mësipërm, do tu shpërndahet pronareve te kuotave te kapitalit themeltar përpjesëtimisht me pjesëmarrjen e tyre, ne përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi, me përjashtim te destinimit te ndryshëm te vendosur nga vete ortaket.

NENI 22 FINANCIMI I ORTAKEVE

Shoqëria mund te marre nga ortaket financime me ose pa shpërblim, ne përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi. Dhënia e këtyre financimeve nga ana e ortakeve është e lire.


NENI 23 MBYLLJA E AKTIVITETIT

Veprimtaria e shoqërisë pushon me vendim te Asamblesë se Ortakeve te shoqërisë kur:

1. Veprimtaria e shoqërisë është negative;
2. Veprimtaria e shoqërisë është e pamundur;
3. Shpërndahet me vullnet te ortakeve;
4. Riorganizohet ne një forme tjetër;
5. Si dhe ne çdo rast tjetër te parashikuar nga ligji.

NENI 24 LIKUIDIMI

Kur verifikohet një nga shkaqet e parashikuara ne Nenin 23 te këtij Statuti, Asambleja e Ortakeve cakton një ose me shume likuidatorë te cilët do te kryejnë te gjitha veprimet e nevojshme përlikuidimin e saj, duke likuiduar ne radhë te pare detyrimet e shoqërisë ndaj shtetit e me pas ndaj te trentëve.



Ne rast se kapitali i shoqërisë do të jete i pamjaftueshëm, ortakët e shoqërisë janë detyrimin për të derdhur kuotat e tyre deri në nivelin e pjesëmarrjes në kapitalin fillestar.

ENI 25

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve ose ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë dhe që ka lidhje me të drejta të disponoheshë në lidhje me marrëdhëniet e tyre me shoqërinë do t'i drejtohen për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ENI 26

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

Çdo gjë që nuk është parashikuar në këtë statut do të disiplinohet nga dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Tiranë, më 16.09.2024

Ortakët e shoqërisë "E2 ESTATE" sh.p.k

Z.Brion Brinja

Brion Brinja 

Z.Eugent Shkurti

Eugent Shkurti 